



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE**

Nr. 5250/___Prot.

Tiranë, më ___/___/ 2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË
SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: OE: **EVITA shpk – me NIPT L31714005J** adresa: Rr. Sami Frashëri, Nr. pasurie 7/120-N1, Zona Kadastrale 8270, Vol.28, faqe 155, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: e hapur mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike - mallra.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-80581-12-01-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve” për një periudhë 12 mujore, sipas listës së miratuar nga OBSH –Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit 496,000,000 (katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion) lekë pa TVSH.**

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Kontratat mund të lidhen nga AK përfituese brenda afatit 12 muaj nga data e nënshkrimit të MK nga palët.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, ka qenë pjesëmarrës në këtë procedurë ofertuesi me vlerën përkatëse të ofruar:

- 1. CONFRU SRL – me Part.IVA:IT 07900800728** dhe ofertë ekonomike 1,596,000 euro. Adresa: Via Dell’Arte Bianca 16, 70056 Molfetta (Ba).
- 2. EVITA shpk – me NIPT L31714005J** dhe ofertë ekonomike 492,000,000 lekë pa TVSH. Adresa: Rr. Sami Frashëri, Nr. pasurie 7/120- N1, Zona Kadastrale 8270, Vol.28, faqe 155, Tiranë.
- 3. SWISSMED shpk – me NIPT K81323024G** dhe ofertë ekonomike 496,000,000 lekë pa TVSH. Adresa: Njësia Bashkiake nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa 92, seksioni 4, hyrja 28, kodi postar 1026, zona kadastrale nr. 8310, Tiranë.
- 4. KRIJON shpk me NIPT K12023001A – pa ofertë ekonomike.**

* * *

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **CONSFUR SRL – me Part.IVA:IT 07900800728** dhe ofertë ekonomike 1,596,000 euro. Adresa: Via Dell'Arte Bianca 16, 70056 Molfetta (Ba).
2. **KRIJON shpk me NIPT K12023001A – pa ofertë ekonomike.**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Shoqëria, **KRIJON shpk- me NIPT K12023001A** – nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në kriteret e përgjithshme dhe të vecanta për kualifikim. Gjithashtu kjo shoqëri nuk kanë dorëzuar ofertë ekonomike. Rrjedhimisht oferta e kësaj shoqërie rezulton si jo e plotë dhe e parregullt.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE **CONSFUR SRL – me Part.IVA:IT 07900800728** rezultoi se: Në lidhje me pikën 2 *Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST pika 2.1.a Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje)*; Operatori ekonomik nuk e ka plotësuar formularin sipas Shtojcës 1 të DST, ku oferta e paraqitur rezulton në Euro dhe gjithashtu nuk është pasqyruar fakti nëse oferta e ka të përfshirë TVSH-në në çmimin e ofertuar apo jo.

Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuar në DST, konkretisht me Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*.

- Konkretisht Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, 2.3.1 *Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo me te vogël se 198,000,000 Lekë, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në lidhje me këtë kriter rezulton se OE nuk ka paraqitur asnjë kontratë.*

- Në DST pika 2.3.3 *Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për artikullin e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe). Në lidhje me këtë kriter rezulton se katalogët teknikë për artikullin e ofertuar nuk janë të plotë dhe nuk përmbajnë instruksione përdorimi. Gjithashtu nuk rezulton të jenë të markuar sipas kërkesave në DST.*

- 2.3.5 *Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import, eksport, tregetim të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. OE nuk ka paraqitur dokumenta që vërtetojnë plotësimin e këtij kriteri.*

- 2.3.9 *Çertifikatën e regjistrimit të testit antigen pranë AKBPM sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi. Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri rezulton që ky OE nuk ka paraqitur certifikatën e regjistrimit të testit antigen, por vetëm një formular jo formal.*

- 2.3.10 Operatori duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të leshuar nga MSHMS sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit nuk rezulton që të jetë paraqitur një dokumentacion i tillë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me përmbushjen e specifikimeve teknike rezulton që nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DST.

Konkretisht kërkohet:

- “Testet e antigenit të jenë të aprovuara dhe të renditen në listën e OBSH-së (WHO)” – Pas verifikimeve rezulton se artikulli i ofertuar nuk është i aprovuar në listën e OBSH-së. Shiko linkun: https://extranet.who.int/pqweb/sites/default/files/documents/201215_EUL_SARS-CoV-2_product_list.pdf

- “Testi të jetë i regjistruar pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” - OE nuk e ka sjellë një certifikatë që provon këtë specifikim.

- “Të kryhet në mostra të hundës, faringut ose nazofaringealit” – vetëm nasale.

- “Të ketë specifikim klinik > 99% per SARS-CoV-2” – e ka 97.32%.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [**“Evita” shpk - me NIPT L31714005J**, Adresë: Rr. Sami Frashëri, Nr. pasurie 7/120- N1, Zona Kadastrale 8270, Vol.28, faqe 155, Tiranë] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [**492,000,000 (katërqind e nëntëdhjetë e dy milion) lekë pa TVSH**]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [autoritetit kontraktor përfitues/MSHMS /Drejtoria e Prokurimeve, Koncesioneve dhe PPP] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _5_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 28.01.2021

Ankesa: JO

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

GELARDINA PRODANI